REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

NJOFTIM

PËR SHPALLJEN E KËRKESËS PËR KANDIDATURA NGA RADHËT E GJYQTARËVE

PËR KOMANDIM NË ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 86, shkronja "d", të Ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", në nenet 53, 54, 57 dhe 58 të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me vendimin nr. 486, datë 14.11.2022 ka vendosur:

"*Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për: "Këshilltar*";

Këshilli i Lartë Gjyqësor fton:

Çdo gjyqtar të interesuar, që plotëson kushtet dhe kriteret e komandimit, për të paraqitur kërkesë për komandim.

Kohëzgjatja e komandimit, në pozicionin e shpallur, është deri në 5 (pesë) vjet.

Kohëzgjatja e komandimit, në pozicionin e shpallur mund të përfundojë para afatit:

a) me kërkesë të gjyqtarit, për shkaqe të justifikuara;

b) kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit.

Kushtet e komandimit, në pozicionin e shpallur, janë:

a) Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;

b) Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;

c) Kandidati nuk duhet të jetë i komanduar;

ç) Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë, duhet të ketë shërbyer jo më pak se 5 (pesë) vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit;

d) Kandidati nuk duhet të ketë masë disiplinore në fuqi.

Kriteret e komandimit për pozicionin "Këshilltar", janë:

a) Kandidati magjistrat në kohën e kandidimit të ketë të paktën 2 vjet përvojë pune si magjistrat;
b) Kandidati magjistrat duhet të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
c) Kandidati magjistrat që ka përvojë profesionale në sistemin gjyqësor, në administratë publike, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, apo organizatat ndërkombëtare ka përparësi në raport me kandidatët e tjerë."

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është data 30 Nëntor.

Dokumentacioni i aplikimit (Kërkesa për komandim dhe Vetëdeklarimi) duhet të dorëzohet nga kandidati në Zyrën e Protokollit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në adresën Rruga "Ana Komnena", ndërtesa "Poli i Drejtësisë" Tiranë.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit, lista e kandidatëve do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Të gjithë të interesuarit për më tepër informacion lidhur me procedurat e kandidimit mund të vizitojnë faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke u konsultuar me **Vendimin nr.486, datë 14.11.2022**, "Për Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë".

14.11.2022